34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktojnë jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë - shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës është min 10 % e vlerës së kontratës ose 13,987.30 € së nënshkruar nga data e nënshkrimit të kontratës me validitet - deri me 30.10.2025 nga një Bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, apo kompani e sigurimeve e licensuar nga BQK.
Përgjegjësi dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <u>2 ditëve</u> nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : Dy ditë pas nënshkrimit të kontratës (Varësisht nga kushtet atmosferike, në konsultim me menaxherin e projektit)
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës - deri me 30.09.2025
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës
Regjistri i punës	20.1	Një regjister i punës do të mbahet nga ana e kontraktuesit

Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit të punëve – i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit të punëve - të Autoritetit Kontraktues. Menagjer i projektit nga AK është: Xhylbehar Taipi Menagjer mbikqyres i kontrates nga AK është: Bean Haxhiasi Menagjer i projektit nga OE është:Nail Bahtijari
Pagesa		Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit, pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës, kurse pjesa tjetër e kontratës do të realizohet pas perfundimit te punimeve te percjellura me raport nga ana e menaxherit te kontrates dhe raportit nga ana e komisionit te pranimit teknik te projektit. Vërejtje- Për vitin 2024 janë paraparë mjete në vlerë prej 80,000.00euro, kurse për vitin 2025 mjete prej 59,873.00euro. Nëse Operatori Ekonomik nuk mund ti realizoj punimet në vlerën e paraparë për këtë vitë atëherë Autoriteti Kontraktues do të bëjë ndërprerjen e kontratës dhe konfiskimin i sigurimi i ekzekutimit te kontratës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk ka pagesë paraprake.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: E vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti e lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e pergjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm.
siguria e punëtorëve		Operatori ekonomik që ka nënshkruar kontratën mbanë të gjithë përgjegjësinë për vdekjen, lëndimet, sëmundjet dhe çdo dëmë tjetër të punëtorëve gjatë zbatimit të projektit, si dhe që Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë përgjegjës për asgjë që ndodh gjatë zbatimit të projektit.
Sigurinë e banorëve, këmbësorëve dhe automjeteve		Punimet e ndërtimit do të kryhen në mënyrë që të garantojnë sigurinë e banorëve, këmbësorëve dhe automjeteve në afërsi. Materialet e mbeturinave do të asgjësohen në mënyrën e duhur në përputhje me rregulloret standardet, si dhe që

		Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë përgjegjës për asgjë që ndodh gjatë zbatimit të projektit.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimin.

KUBËZIMI I RRUGËVE NË RRUGEN LLOKUV DHE JEZERQE NË FSHATIN RESTELACË-DRAGASH

A

KUBËZIM I RRUGËS AKSI 1, L= 687.98 m ; S = 2784 m²

Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitetet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare

PUNËT PREGADITORE					
I					
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1.1	Shënimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatën punimet .Llog në m2	m2	3127.00	0.20 €	625.40 €
1.2	Identifikimi dhe dislokimi i instalimeve nëntoksor dhe mbitorësorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimit për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubëzimin e kubëzave në rrugët lokale të fshatit .Llog në m2	m2	3127.00	0.20 €	625.40 €
1.3	Shënimi dhe inçizimet gjeodezike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatën punimet .Llog në m²	m2	3127.00	0.20 €	625.40 €
Gjithsej: Pos I					1,876.20 €

PUNIMET TOKËSORE					
II					
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Gërryerja ,gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndërtimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashësi 10-20 deri ne 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terenit me ramjet e duhura duke përfshi edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dheut te germuar ne deponin te cilen e cakton investitori .Llog në m3 me të gjitha shpenzimet.					
2.1	Gërmimi me makineri (70%)	m3	1531.00	3.00 €	4,593.00 €
2.2	Gërmimi me dorë (20%)	m3	437.00	3.00 €	1,311.00 €
2.3	Gërmimi me çekan (10%)	m3	218.00	3.00 €	654.00 €
2.4	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rruges , para se të vendosen shtresat e tamponit .Llog me të gjitha shpenzimet	m2	3127.00	1.00 €	3,127.00 €
Gjithsej: Pos II					9,685.00 €

III	PUNIMET E MBUSILJES (TAMPONI)
-----	-------------------------------

POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=650 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve. Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
3.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm t=20cm	m3	625.00	10.00 €	6,250.00 €
	Furnizimi, transporti, shtrirja,nivelizimi i baze dhe punimi i bazës së rruges , me materiali guror nga gurit të thyer fraksion(0-32) mm, me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues.Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv= 500 kg/cm2 . Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
3.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm , t= 10 cm	m3	278.00	10.00 €	2,780.00 €
	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t=5 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv= 500 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
3.3	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm t = 5 cm	m3	139.00	10.00 €	1,390.00 €
Gjithsej: Pos 3					10,420.00 €

IV	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE				
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
	Furnizimi, transporti dhe montimi i elementeve nga betoni, llogaritur te gjitha punimet e nevojshme, nga betoni i klasit C 30/37 , d=8cm forma e gjeometris së kubëzave ,kompetene e percaktuar nga Investitori.Në çmim të parashifet edhe Furnizimi,transporti dhe shperndarja e reres (filerit) per mbushjen e fugave ne sipërfaqen e cila eshte e kubëzuar. Vrejtje : Ruga e cila kubëzohet në tërësi të sipërfaqes zgjeruese prej muri në murë kur nuk ka gurë skajor përforcimi i kubëzave bëhet me beton në tërë gjatësin e rrugës të shprehur në m2 në dy anët e rrugët përgjatë perimetri të rrugës.				
4.1	Furnizimi , transporti dhe montimi i kubëzave duke llogaritur në çmim edhe mbushjen e fugave me rërë(filer)	m2	2784.00	12.50 €	34,800.00 €
4.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i skajoreve nga betoni C-30/37 diam.(15x25x80) cm, me baze betoni llogaritur me te gjitha punimet e tjera te nevojshme.	m'	1374.00	8.00 €	10,992.00 €
Gjithsej: Pos 4					45,792.00 €

V	PUNIMET E LËSHESAVE RRUGËORE				
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
	Punimi i lëshesave tjeore të rruges me gypa te betonit , pjesëve kaluese dhe kanaleve të mbyllura në disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna në projekt . Në çmim është llogaritur hapja e kanalit dhe vendosja e rërës, furnizimi dhe vendosja e gypit armuar, duke duke përfshirë edhe kokën hyrëse dhe dalëse të lëshesës nga beton armeja sipas detalit teknik të prezantuar në projekt llog në m' me të gjitha shpenzimet.I.log. në m'				

5.1	Lëshes gipore Ø 600mm deri 10 m gjatësi. Llog. në m'	m'	25.00	50.00	1,250.00 €
Gjithsej: Pos 5					1,250.00 €

A	REKAPITULIMI - KUBËZIMI RRUGËS AKSI I :
---	---

I	PUNËT PREGADITORE	1,876.20 €
II	PUNIMET TOKËSORE	9,685.00 €
III	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)	10,420.00 €
IV	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE	45,792.00 €
V	PUNIMET E LËSHESAVE RRUGËORE	1,250.00 €
TOTALI ME TVSH		69,023.20 €

KUBËZIMI I RRUGËVE NË RRUGEN LLOKUV DHE JEZERQE NË FSHATIN RESTELIC Ë-DRAGASH	
B	KUBËZIMI I OBORRIT TË SHKOLLËS FILLORE ; S = 379.20 m²

Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për t'u marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar t'i kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare

I	PUNËT PREGADITORE				
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
I.1	Shënimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatën punimet .Llog në m2	m2	379.20	0.20 €	75.84 €
I.2	Identifikimi dhe dislokimi i instalimeve nëntoksor dhe mbitorësorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit parandalimit dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimit për shkyqe dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubezimin e kubëzave në rrugët lokale të fshatit. Llog m2	m2	379.20	0.20 €	75.84 €
I.3	Shënimi dhe inçizimet gjeodezike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatën punimet .Llog në m'	m2	379.20	0.20 €	75.84 €
Gjithsej: Pos I					227.52 €

II	PUNIMET TOKËSORE				
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)

Gjyryerja, germimi dhe largimi i dhent të kat III -V Me makina ndërtimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashësi t = 20 deri në 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terrenit me ramjet e duhura duke përfshirë edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dhent te germuar ne deponin te cilen e cakton investitori 1.1og m3 me të gjitha shpenzimet.					
2.1	Germimi me makineri (70%)	m3	83.61	3.00 €	250.84 €
2.2	Germimi me dorë (20%)	m3	23.89	3.00 €	71.67 €
2.3	Germimi me çekan (10%)	m3	11.94	3.00 €	35.83 €
2.4	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës , para se të vendosen shtresat e tamponit 1.1og me të gjitha shpenzimet	m2	379.20	1.00 €	379.20 €
Gjithsej: Pos 2					737.54 €

PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)					
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=650 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve. Vërejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm t=20cm	m3	79.63	10.00 €	796.32 €
Furnizimi, transporti, shtrirja,nivelizimi i bazes dhe punimi i bazës së rrugës , me materiali guror nga gurit të thyer fraksionit (0-32) mm, me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues.Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2 . Vërejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm , t = 10 cm	m3	39.82	10.00 €	398.16 €
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t = 5 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv= 500 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.3	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm t= 5 cm	m3	19.91	10.00 €	199.08 €
Gjithsej: Pos 3					1,393.56 €

PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE					
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Furnizimi, transporti dhe montimi i elementeve nga betoni, llogaritur te gjitha punimet e nevojshme, nga betoni I klasit C 30/37 , d=8cm, forma e gjeometris së kubëzave ,kompetene e përcaktuar nga Investitori.Në çmim të parashifet edhe Furnizimi,transporti dhe shpërndarja e reres (filerit) per mbushjen e fugave ne siperfaqen e cila eshte e kubëzuar. Vërejtje : Ruga e cila kubëzohet në tërësi të sipërfaqes zgjeruese prej muri në murë kur nuk ka gurë skajor përforcimi i kubëzave bëhet me beton të tërë gjatësin e rrugës të shprehur në m2 në dy anët e rrugës përgjatë perimetrit të rrugës.					

4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i kubëzave duke llogaritur në çmim edhe mbushjen e fugeve me rërë (fller)	m2	379.20	13.00 €	4,929.60 €
4.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja betonit C 30/37 për shtangimin e kubëzave në pjeset anesore të rrugës.	m3	3.20	100.00 €	320.00 €
Gjithsej: Pos 4					5,249.60 €

B	REKAPITULLIMI BORRIT TË SHKOLLËS FILLORE
----------	---

I	PUNËT PREGADITORE	227.52 €
II	PUNIMET TOKËSORE	737.54 €
III	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)	1,393.56 €
IV	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE	5,249.60 €
TOTALI ME +18% TVSH		7,608.22 €

KUBËZIMI I RRUGËVE NË RRUGEN LLOKUV DHE JEZEROE NË FSHATIN RESTELICE-DRAGASH	
C	KUBËZIMI I RRUGËS AKSI 2 , L= 210.64m S= 630 m²

Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për të marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar të kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare

I	PUNËT PARAPREGADITORE				
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1.1	Shënimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .1.log në m2	m2	667.00	0.20 €	133.40 €
1.2	Identifikimi dhe dislokimi i instalimeve nëntoksor dhe mbitoksorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit parandalimit dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimt për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubëzimin e kubëzave në rrugët lokale të fshatit. 1.log m2	m2	667.00	0.20 €	133.40 €
1.3	Shënimi dhe inçizimet gjeodezike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .1.log në m'	m2	667.00	0.20 €	133.40 €
Gjithsej: Pos 1					400.20 €

II	PUNIMET TOKËSORE				
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)

Çiërryerja ,gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndërtimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashësi t = 20 deri në 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terrenit me ranjet e duhura duke përfshi edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dheut te germuar ne deponin te cilen e cakton investitori .Llog m3 me të gjitha shpenzimet.

2.1	Gërmimi me makineri (70%)	m3	233.00	3.00 €	699.00 €
2.2	Gërmimi me dorë (20%)	m3	66.00	3.00 €	198.00 €
2.3	Gërmimi me çekan (10%)	m3	33.00	3.00 €	99.00 €
2.4	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës , para se të vendosen shtresat e tamponit .Llog me të gjitha shpenzimet	m2	667.00	1.00 €	667.00 €
Gjithsej: Pos 2					1,663.00 €

III PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)					
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës t= 20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=650 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve. Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm t=20cm	m3	133.00	10.00 €	1,330.00 €
Furnizimi, transporti, shtrirja,nivelizimi i bazës dhe punimi i bazës së rrugës , me materialin guror nga gurit të thyer fraksion (0-32) mm, me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues.Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv= 500 kg/cm2 . Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm , t= 10 cm	m3	66.00	10.00 €	660.00 €
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t=5 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv= 500 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.3	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm t= 5 cm	m3	33.00	10.00 €	330.00 €
Gjithsej: Pos 3					2,320.00 €

IV MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE					
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Furnizimi, transporti dhe montimi i elementeve nga betoni, llogaritur te gjitha punimet e nevojshme, nga betoni i klasit C 30/37 , d=8cm forma e gjeometris së kubëzave ,kompetenc e perenktuar nga Investitori.Në çmim të parashifet edhe Furnizimi,transporti dhe shpermdarja e reres (filerit) per mbushjen e fugeve ne siperfaqen e cila eshte e kubezuar. Vërejtje : Ruga e cila kubëzohet në tërësi të sipërfaqes zgjeruese prej muri në murë kur nuk ka gurë skajor përforcimi i kubëzave bëhet me beton në tërë gjatësin e rrugës të shprehur në m2 në dy anët e rrugët përgjatë perimetri të rrugës.					
4.1	Furnizimi , transporti dhe montimi i kubëzave duke llogaritur në çmim edhe mbushjen e fugeve me rërë (filer) .	m2	630.00	13.00 €	8,190.00 €

4.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i skajoreve nga betoni C-30/37 dim.(15x25x80) cm, me baze betoni llogaritur me te gjitha punimet e tjera te nevojshme.	m'	150.00	8.00 €	1,200.00 €
Gjithsej: Pos 4					9,390.00 €

C	REKAPITULIMI - KUBËZIMI RRUGËS AKSI 2 :
---	---

I	PUNËT PARAPREGADITORE	400.20 €
II	PUNIMET TOKËSORE	1,663.00 €
III	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)	2,320.00 €
IV	MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE	9,390.00 €
TOTALI ME +18%TVSH		13,773.20 €

D	MURI MBROJTËS L= 25 m , H=(2.5 : 3.5)m
---	--

I	PUNËT PARAPREGADITORE				
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1.1	Inçizimi i terenit si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit	m'	25.00	1.00 €	25.00 €
1.2	Pastirimi i terenit si dhe prerja e drunjeve , prerja dhe demolimi i murëve ekzistuese betonarme ne tere gjatesin e trases ku do te ndertohet muri mbrojtës. Në qmim kalkulohet edhe bartja e materialit të demoluar beton arme deri të deponia inerte . Llog m'	m'	25.00	1.00 €	25.00 €
Gjithsej 1.1:					50.00 €

II	PUNËT TOKËSORE				
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
2.1	Germimi i dheut i kategorisë së III- VI-të Me makina ndërtimore ne vendet e projektuara si dhe transporti i materialit te germuar ne deponi deri ne 15 km.Llog ne m³				
	Germimi me makineri (70%)	m³	103.08	3.00 €	309.25 €
	Germimi me dorë (20%)	m³	28.88	3.00 €	86.63 €
	Germimi me çekan (10%)	m³	14.44	3.00 €	43.31 €
2.2	Formësimi dhe ngjeshja e nenbazes se themelit te murit me ngjeshmeri 30MN/m2	m'	56.25	1.00 €	56.25 €
2.3	Sigurimi i gropës ndërtimore nga rrëshqitëja e dheut si dhe vendosëja e shenjave të sigurisë konform normave ndërtimore në fuqi	m'	25.00	1.00 €	25.00 €
Gjithsej 1.2:					520.44 €

III	PUNËT E MBUSHJES				
POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)

Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror Fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të liqohet moduli i ngjeshjes Mv= 650 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet të jetë i paisur me ateste paraprake ,dhe atë sipas normave dhe standardeve.

Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtojë testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentojë tek menaxheri kontratës.

3.1	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit 0-63mm nën bazën e themelimit me trashësi t=25cm me ngjeshmeri 50MN/m2.Llog. Në m³	m³	12.50	10.00 €	125.00 €	✓
3.2	Furnizimi, transporti dhe mbushja mbrapa murit me zhavorr te pastër te luntit 63 mm ne tere lartesine e murit me b= 50 cm.Llog. Në m³	m³	12.50	10.00 €	125.00 €	✓
3.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypit te drezhit PVC Ø100 mm prapa murit .Llog. Në m.	m	28.00	2.00 €	56.00 €	✓
3.4	Gypi PVC Ø 70 mm për kullim në murin e bet. arm në çdo 2.0 m .zig zak.	m	25.00	2.00 €	50.00 €	✓
3.5	Furnizimi, transporti dhe mbushja mbrapa murit me materil guror natyror, guret jo me te medhenje se 150mm, ne tere lartesine e murit me ngjeshje ne çdo 30cm.Llog. Në m³	m³	28.13	10.00 €	281.25 €	✓
Gjithsej 1.3:					637.25 €	✓

VI PUNËT E BETONIT DHE BETON ARMES

POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)	
4.1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve te murit mbrojtës nga betoni I thjeshtë C12/15 me trashësi 8 cm, ne çmim te llogaritet vendosja e pahive dhe mimbajtja e betonit. Sipas detalit te dhënë. Llog ne m2	m²	3.20	80.00 €	256.00 €	✓
4.2	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve te murit mbrojtës nga betoni I armuar C25/30 me aditive papërshkueshëm nga uji ne thellesi h= 0.7m dhe gjerësi b=1.50m ,ne çmim te llogaritet vendosja e pahive, fugat e dilatimit ne çdo 6.0 m, dhe mimbajtja e betonit. Sipas detalit te dhënë.	m³	33.00	100.00 €	3,300.00 €	✓
4.3	Furnizimi, transporti dhe betonimi i murit mbrojtës dhe trashësi te ndryshuar nga betoni i armuar C30/37 me aditive papërshkueshëm nga uji. Ne çmim te llogaritet vendosja e pahive, fugat e dilatimit çdo 6 m. Sipas detalit te dhënë.	m³	25.00	100.00 €	2,500.00 €	✓
Gjithsej 1.4:					6,056.00 €	✓

V PUNËT E ARMATURËS

POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)	
5.1	Furnizimi, transporti, prerja lakimi dhe montimi i armatures se brinjzuar S-400/500si dhe vendosja e sajë ne vendin e caktuar per themele dhe murin mbrojtës. Sipas detalit te dhënë.Llog në kg	kg	3,611.00	1.00 €	3,611.00 €	✓
Gjithsej 1.5:					3,611.00 €	✓

VI PUNËT E HIDROIZOLIMIT

POS	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
6.1	Furnizimi dhe lyerja e mureve mbrojtëse në zonën e prapme të muri me të cilën sigurohet skarpata nga rrëshqitjet e masivit shkëmborë me material izolues të flofte bitulit. Llog në m2 me të gjitha shpenzimet	m2	93.75	1.00 €	93.75 €
3.2	Furnizim dhe montimi i shtresës izoluese të hidroizolimit VERTIKAL me material hidroizolues sipas standardeve të aplikueshme të cekur në specifikacionin teknik duke aplikuar material hidroizolues me trashësi 4 mm, vendosja bëhet zonën e prapme të sipërfaqes së murit i cili është mbuluar izolimi me shtresë fillestare me bitulit. Materiali hidroizolues vendoset mbi sipërfaqen izoluese të bitulit, vendosje e materialit hidroizolues lindex + 10 CM mbulim apo ngjajshme bëhet me salldim me flakë. Llog në m2.	m2	93.75	1.00 €	93.75 €
			Gjithsej 1.6:		187.50 €

D	REKAPITULIMI - MURI MBROJTËS
---	------------------------------

I	PUNËT PARAPREGADITORE	50.00 €
II	PUNËT TOKËSORE	520.44 €
III	PUNËT E MBUSIJES	637.25 €
IV	PUNËT E BETONIT DHE BETON ARMES	6,056.00 €
V	PUNËT E ARMATURËS	3,611.00 €
VI	PUNËT E HIDROIZOLIMIT	187.50 €
	TOTALI me +18 % TVSH	11,062.19 €

E	KUBËZIMI I RRUGËS AKSI 3, L= 49.61+ m ; S = 198.44 m²
---	---

